



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitina

Në bazë të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/246, neni 3, 6, 8, 9 dhe neni 10, si dhe buxhetit të planifikuar dhe të paraparë për këtë destinim, Komuna e Vitisë shpall:

KONKURS PUBLIK

Për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Vitisë, për vitin akademik 2019/20

Komuna e Vitisë shpall konkurs publik, për ndarjen e **140** bursave, në vlerë **300 €**, për vitin akademik **2019/20**. Bursat ndahen për studentë të fakulteteve publike. Përparësi kanë studentët e drejtimeve deficitare, studentët e familjeve përfitues të ndihmës sociale, studentët e familjeve të dëshmorëve të luftës, invalid të luftës dhe veteran të luftës, si dhe studentët e familjeve pa prind në jetë.

Kriteret për aplikim:

- Të jenë studentë të Komunës së Vitisë;
- Të jenë studentë të rregullt në Universitetin Publik të Republikës së Kosovës;
- Të jenë studentë të fakulteteve, drejtimeve deficitare, si: Matematikë, Fizikë, Gjuhë Gjermane.

Në kushte të barabarta, përparësi në përfitimin e bursës kanë:

- Studentët me asistencë sociale;
- Studentët e veteranëve të luftës;
- Studentët e familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës;
- Studentët e gjinisë femërore.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Vërtetimi i regjistrimit të semestrit për vitin akademik 2019/20;
- Për studentët fillestar diploma e shkollës së mesme, indeksin e fakultetit fotokopje (regjistrimin e semestrit dëshmi);
- Studentët të cilët kanë përfunduar ndonjë vit akademik të sjellin çertifikatën e notave (indeksin fotokopje).

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Drejtorin Komunale të Arsimit në Viti.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, ndërsa dokumentet e pakompletuara nuk merren në shqyrtim.

Viti, më 14.11.2019

DKA-Viti